



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW**

PSH. Nr. 97/17

**PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT** i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në përbërje prej: z. Tefik Sylejmani - Kryetar, z. Nuhi Paqarizi – Referues, z. Goran Milenkovic – anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE “Luani” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës”, me nr. të Prokurimit: AP : 616/16/115/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, më: 17.05.2017, mori këtë :

**V E N D I M**

**I.Hedhet**, posht si e pa lejuar ankesa e OE “Luani” - Prishtinë, lidhur me procedurën e prokurimit me titull: “Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës”, me nr. të Prokurimit: AP :616/16/115/211.

**II.VËRTETOHET**, vendimi i AK - Komuna e Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës”, me nr. të Prokurimit: AP :616/16/115/211 dhe njëkohësisht autorizohet Autoriteti kontraktues që të vazhdoj me tutje me këtë aktivitet te prokurimit.

**III.** Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë prokurim .

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me këtë ligj.

V. Meqenëse pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues “Luani” me seli Prishtinë janë të paqëndrueshme, i bëhet konfiskimi i sigurimit të ankesës.

## ARSYETIM

AK-KK Prishtinë për këtë aktivitet të prokurimit e ka bërë njoftimin për kontratë me 28.12.2016, procedurë e hapur, kontratë për shërbime me vlerë të mesme, afati për ofertim ka qenë data 24.01.2017, ku të njëjtën datë është bërë hapja ofertave.

Kriter për dhënie ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, kontratë kornizë 36 muaj.

Për këtë aktivitet kanë ofertuar 8 OE, ku AK ka formuar komisionin prej 3 anëtar për vlerësimin e ofertave.

Komisioni ka konstatuar se janë gjithsejtë 7 OE të përgjegjshëm.

Pas krahasimit dhe vlerësimi të ofertave komisioni ka rekomanduar që OE “Alpha Security”, ku në shenjë mospajtimi OE tani ankues “Luani” nga Prishtina me 05.04.2017 parashtrohet ankesë në OSHP ku paraqet pretendimet ankimore me arsyetim se janë shkel dispozitat e LPP neni 7 pika 1, neni 2 dhe 3, neni 54, 56, 59,, 68 të LPP-së.

OE “Luani” - Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP më 05.04.2017, me nr. të protokollit, 97/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të OE “Alpha security” - Prishtinë, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së dhe atë të nenit 7. 1,2 , 3 nenit 54,56,59 dhe 68 .

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së nr. 04/L-042, ka autorizuar ekspertin shqyrtues dhe atë teknik, për të shqyrtuar procedurën e zhvilluar lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertet shqyrtues – teknik, në raportin e datës: 02.05.2017, ka konstatuar se AK-ja, i ka respektuar dispozitat e LPP-së dhe se pretendimet ankimore të parashtuara në ankesë janë të paqëndrueshme, për faktin se OE i rekomanduar për kontratë e përmbush kërkesën për qarkullim 400,000.00 euro. Eksperti shqyrtues, pasi ka ekzaminuar ofertën e të rekomanduarit për kontratë sqaron se në ofertën gjendet qarkullimi bankar mbi 500,000.00 euro për tri vitet e fundit, prandaj ky pretendim i OE ankues është i paqëndrueshëm dhe njëherit në lidhje me pretendimin se OE i rekomanduar për kontratë me pagën e deklaruar nuk arrin ti përmbush obligimet tatimore të parapara me ligj, eksperti teknik ka sqaruar se kalkulimin e pagesë bruto nga kalkulatori i pagave, në faqen zyrtare të ATK-së të cilën e ka bashkangjitur në ekspertizë) ka shpjeguar kalkulimin e pagës, nga e cila shihet se janë të përfshira taksat dhe kontributet. Andaj, duke u bazuar në sqarimin e dhënë eksperti teknik ka vlerësuar se ky pretendim i OE ankues është i paqëndrueshëm.

Në fund ekspertet shqyrtues-teknik, duke u bazuar në sqarimet e dhëna në raport të ekspertizës i kanë propozuar panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar dhe njëherit i kanë propozuar panelit shqyrtues që vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të mbetet në fuqi.

OE ankues “Luani” – Prishtinë, përmes parashtresës e ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e eksperteve shqyrtues- teknik te datës 02.05.2017.



AK-ja, poashtu, me anë të parashtrësës e ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me raportin dhe konstatimet e eksperteve shqyrtues-teknik, për këtë aktivitet të prokurimit.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, më 17.05.2017, në të cilën ishin prezent anëtarët e panelit shqyrtues, ekspertet shqyrtues - teknik, përfaqësuesi i autorizuar OE ankues, përfaqësuesi i AK-së dhe përfaqësuesi i OE te rekomanduar për kontratë. Në seancë u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, përgjigjja e AK-së mbi raportin e ekspertizës.

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të OE "Luani" z. Beqiri i cili deklaroj: Ne qëndrojmë në tërësi pranë asaj që kemi shkruar në ankesë, sepse mendojmë se janë bërë disa shkelje të LPP-së andaj edhe kemi paraqitur ankesë pranë OSHP-së. Ne jemi ndalur tek disa kritere të cilat mendojmë se nuk janë respektuar nga ana e komisionit të AK-së dhe zyrës së prokurimit. Në dosje të tenderit është kërkuar qarkullimi financiar për tri vitet e fundit 400.000€ dhe të dëshmohej me raport financiarë nga një bankarë e licencuar në Kosovë, ose raport i auditorit ose deklaratë vjetore e dorëzua në ATK. Ndërsa gjatë shikimit të dokumenteve të OE fitues, ky OE ka deklarua vetëm një konfirmim nga banka e cila nuk jep dëshmi të mjaftueshme ashtu siç ka thënë AK-ja si dhe eksperti, sepse konfirmimi dh raporti bankar janë dy gjëra pak më të ndryshme. Konfirmimi përmbledh gjitha ato çka kanë mund të edhe të mos hynë si qarkullim dhe të mos jenë të natyrës së ngjashme. Pika dytë, te kriteri për pagë të punëtorit që është kërkuar nga AK-ja ku thuhet që paga të jetë jo më pak se 230 € bruto, çmimi i dhënë nga OE fitues nuk mund të paguan punëtorin me këtë çmim dhe ti paguaj orët e punë sipas ligjit në fuqi numër 03/L-2012. Andaj kur themi këtë ne mbështetemi në një analizë të marr nga ATK-ja ku thuhet kalkulo pagën. Aty kemi vërejt se nëse një punëtor sigurimi punon 160 orë të parapara sipas ligjit, mirëpo tek ne punojnë deri 174 orë, atëherë në llogaritje del kjo që e keni të bashkangjitur edhe në ankesë, si llogaritet paga punëtorit.

Në llogaritjen 230€ bruto nuk hynë 5% i tatimit në pagë që duhet kompania të paguaj për punëtorin, kështu që 230€ i shtojmë 11.50€ na del 241.50€. Kësaj duhet shtuar 18% për TVSH atëherë TVSH janë 43.47€, totali për një pagë me taksa del 284.97€.

Kur i pjesëtojmë me 174 orë, na jep çmimin 1.6377 për një orë pune, pa e llogaritu ligjin e punës i cili nëse punon më shumë se 160 orë duhet paguar me shtesë, orët e natës prej 22.00 deri 06.00 me plus 30% të pagës dhe orët e festave apo vikendeve duhet paguar plus 50%, si dhe pushimin vjetorë apo mjekësorë që duhet shfrytëzua një punëtor. Andaj ne mendojmë se kompania që është shpall fitues nuk ka plotësuar kriterin që ne e thamë më herët, pasi ne kemi bërë pyetje para dorëzimit të ofertës tek AK-ja, që është bashkangjitur në shkresat e lëndës.

Kemi thënë nëse në çmim të dhënë nga ndonjë kompani nuk plotëson kriteret pagën e punëtorit dhe ligjin e punës, a do llogaritet çmim jo normalisht i ulët. Përgjigjja e AK-së, ka qenë "në çmim duhet të përfshihen gjitha detyrimet tjera ligjore, financiare dhe nëse këto detyrime nuk mbulojnë pagën e punëtorit atëherë mund të trajtohet si jo normalisht i ulët.

Qëndrojmë në tërësi pranë ankesës dh pretendimeve ankimore dhe rekomandojmë që lënda të kthehet në Rivlerësim.



Në vazhdim fjala iu dha përfaqësueses së AK - Komunës së Prishtinës, znj.Dalipi e cila deklaroj: Ne si AK pajtohemi me raportin e ekspertit në dy sqarimet e dhëna. Duhet të cek se OE i rekomanduar i plotëson gjitha kriteret dhe kërkojmë nga OSHP-ja, të aprovohet vendimi i AK-së, dhe të refuzohet ankesa si e pabazuar. AK-ja ka nevojë më shumë se secilin projekt që ky të realizohet pasi kemi nevojë dhe shpresojmë për një vendim të drejtë nga paneli shqyrtues.

Kryetari i panelit pyeti përfaqësuesin e AK-së, se a është kërkuar paga bruto apo neto e punëtorit?

Në përgjigje znj.Dalipi deklaroj: Është kërkuar paga bruto.

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues z.Mulaj i cili deklaroj: OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar konfirmim nga banka mirëpo kjo plotëson kërkesën e AK-së, pasi vet kërkesa ka qenë e tillë. Sa i përket pagës kam bërë kalkulimin e pagës nga faqja zyrtare e ATK edhe pse kusht ka qenë i AK-së 230€ pa hy në kalkulime. Kontributi punëdhënësit 5% është i përfshirë në formën e ATK-së, andaj OE i rekomanduar për kontratë e ka të përfshirë këtë në çmimin e dhënë.

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues z.Basha i cili deklaroj: Duhet ti cek paneli që përveç tjerash janë edhe tre OE tjerë me çmim më të ulët se OE ankues, për të cilët OE ankues nuk ka pretenduar se janë të papërgjegjshëm, pra nuk i ka atakuar sipas dispozitave të nenit 4.1.26 të LPP-se poashtu ne lidhje me qarkullimin financiar sipas kërkesës OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se e mbulon qarkullimin financiar prej 400,000.00 euro. Qëndrojmë pranë raportit të ekspertizës, konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në raport.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit të komisionit vlerësues të AK-së, shqyrtimit të pikës pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues – teknik, të cekur në ekspertizë, parashtrësës së OE ankues, parashtrësës së AK-së, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton dhe vlerëson se AK-ja në harmoni me nenin 59 të LPP-së, ka bërë Vlerësimin, Ekzaminimin dhe Krahasimin e ofertave, për faktin se gjatë seancës dëgjimore, eksperti shqyrtues sqaroi se AK-ja, në dosje të tenderit ka kërkuar që OE-të, duhet të ofrojnë dëshmi të kënaqshme se ka qarkullim financiar në tre vitet e fundit (2013, 2014 dhe 2015) në vlerë minimale prej 400,000.<sup>00</sup> €, Lidhur me këtë kërkesë eksperti shqyrtues sqaroi se në ofertën origjinale OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar dëshmi nga banka se ka qarkullim bankar mbi 500,000.00 euro. Prandaj, Paneli shqyrtues konstaton dhe vlerëson se ky pretendim është i paqëndrueshëm.

Po ashtu paneli shqyrtues gjeti se OE"Luani"në këtë rast ankues ka qenë i renditur i 4 me çmim dhe i njëjti nuk ka atakuar dy OE tjerë të cilët kanë çmimin më të ulët se ai OE"Luani" Kurse kërkon që lënda të kthehet në ri-vlerësim, nga kjo paneli konstaton se OE"Luani" nuk ka interes juridik dhe material konform nenit 4.1.26 lidhur me nenin 111 të LPP-ës sepse i njëjti në asnjë mënyrë nuk mund të jetë fitues i kësaj kontrate edhe sikur lënda të kthehet në ri-vlerësim sepse ka OE që kanë çmimin më të lirë se ankuesi.

Gjithashtu Paneli shqyrtues, gjithashtu duke u bazuar në sqarimet e dhëna nga eksperti teknik lidhur me pagën e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, vlerëson se është i paqëndrueshëm ky pretendim i OE ankues, ku OE ankues edhe gjatë seancës dëgjimore deklaroj se në pagën 230 euro nuk hyjnë kontributet prej 5%. Paneli shqyrtues konstaton se paga e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë është Bruto që do të thotë se në pagën bruto përfshihen të gjitha kontributet, ndërsa në lidhje me kalkulimin e pagës dhe nxjerrjen e kontributeve që burojnë nga

paga, paneli shqyrtues pati parasysh kalkulimin e pagës të cilin e bënë Administrata Tatimore e Kosovës si institucion kompetent, të cilin e ka te publikuar në ueb faqen zyrtare të saj.

Paneli shqyrtues pasi shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pas dëgjimit të palëve gjeti se AK ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 7,59.56,54 dhe 68 të LPP-ës.

Prandaj Paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së, si dhe duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike :**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur nuk mund të ushtron ankesë, por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh, pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë kërkesë-padi në Gjykatën Themelore - Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues  
Tefik Sylejmani

